

VENDIM
Nr. 547, datë 16.8.2012

PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE
“PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2012-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit, nga të cilat 24 (njëzet e katër) për nxënës të viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) për nxënës të viteve të para, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2012-2013.

2. Vlera e bursës të jetë 680 euro për nxënës në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e bursës të paguhet, për çdo nxënës, në lekë.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, sipas kriterëve ekonomike dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha